

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Humbje e hidhur në Vjenë, Kosova mundet 3-1 nga Austria, goli i Zhegrovës nuk mjafton
ADRESA	https://www.gazetatema.net/sport/humbje-e-hidhur-ne-vjene-kosova-mundet-3-1-nga-austria-goli-i-zhegroves-nu-i588807
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 18:21:16 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 18:20:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f5ed37c47afadb5c926db5e6e609e870746f244e4eb97271426ce397a3dfffd05
TEKSTI	5f11a3018c81899adb11e49e0b687f6de104e8eb68e53d745cef1925420f3752
PAMJA	af6e7cdc354efb55c78d18ea072a6290199e2cb71aaf25aadeef208bd216110ef

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	cc387b771160b1a87cec6ef1f093b91649a3c52f02ecb5824070f3c4c996557b
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b1c7a27947b4cc546e59bf39e541eaf49f294f8d53ee0afce777d7f589624631
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/cc387b771160b1a87cec6ef1f093b91649a3c52f02ecb5824070f3c4c996557b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)
- [Hosteni](#)

English

Built and Monetized by

English

ie Humbje e hidhur ne Vjene, Kosova mundet 3-1 nga Austria, goli i Zhegroves nuk mjaftonÇatia e baneses shembet nga rraket, humb jeten 70-vjeçari ne FierSkenar lulte/fundit

Humbje e hidhur në Vjenë, Kosova mundet 3-1 nga Austria, goli i Zhegrovës nuk mjafton

Tema

27 Shtator 2026, 20:20Sport TEMA



Ka përfunduar me një rezultat zhgënjyes përballja mes Austrisë dhe Kosovës e vlefshme për Ligën e Kombeve, ku Dardanët janë mposhtur me shifrat 3-1 në Vjenë.

Skuadra e drejtuar nga Franco Foda e nisi ndeshjen me synime të qarta për të vazhduar ecurinë pozitive pas suksesit ndaj Irlandës, por u përball me një Austri tejet kërkuese dhe efikase në fushën e saj në “Ernst-Happel-Stadion”. Vendasit arritën të zhblokojnë shifrat dhe të kalojnë në avantazh në minutën e 23-të, falë golit të shënuar nga David Affengruber. Kur të gjithë po prisnin vërshtëllimën e gjyqtarit për të shkuar në dhomat e zhveshjes, austriakët i dhanë një tjetër goditje të rëndë ekipit tonë. Junior Adamu arriti të dyfishojë epërsinë në minutat shtesë të pjesës së parë, saktësisht në minutën 45'+2.

Në pjesën e dytë, trajneri Foda bëri përpjekjet e tij për të ndryshuar marshin e lojës, por ishin sërish austriakët ata që gjetën rrugën e rrjetës. Në minutën e 61-të, Carney Chukwuemeka thelloi epërsinë në 3-0, duke i bërë gjërat edhe më të vështira për Dardanët.

Reagimi i vetëm konkret i Kosovës erdhi në minutat e fundit të takimit. Ishte Edon Zhegrova ai që mori përsipër përgjegjësinë dhe u tregua i saktë nga pika e bardhë e penalltisë në minutën e 83-të, duke shënuar golin e ngushëllimit për ekipin tonë. Ky ishte dhe rezultati përfundimtar që vulosi takimin, 3-1 në favor të Austrisë. Me këtë humbje, Kosova bën një hap pas në grup, ndërsa vëmendja tashmë kthehet te përmirësimi i gabimeve për ndeshjet e radhës.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Përpara ndeshjes me Turqinë: Nuk kemi presion, shoh shumë shqetësim. Edhe para Evropianit që fituam nuk kishte besim](#)

19:50 Sport

Not, çiklizëm dhe vrap/ U mbajt edicioni i 6-të i 'Tiranathlon' - Në garë morën pjesë 116 sportistë nga bota

18:50 Sport

[Pas fitores me Bjellorusinë, kuqezinjtë vijojnë përgatitjet për duelin ndaj San Marinos](#)

17:30 Sport

[Skandali financiar në Angli: Klubet e Premier League përgatisin padi 930 milionë euro kundër Manchester City-t](#)

13:40 Sport



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.